

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	611-25-9865-5-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	"N.N.T KORABI"
NUI	810248791
Adresa	Qikatove e Vjeter
Vendi	Drenas
Kodi postar	13000
Numri Telefonit	049393266
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Avdullah Morina
Adresa elektronike	nntkorabi@gmail.com
Data e parashtrimit të kërkesës	03.11.2025

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftim per Kontrat - 29.10.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-se

Neni 7 i LPP-se

Neni 52 i LPP-se

Neni 56 i LPP-se

Neni 59 i LPP-se

Neni 60 i LPP-se

Neni 61 i LPP-se

Neni 64 i LPP-se

Neni 65 i LPP-se

Neni 69 i LPP-se

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022

Neni 10 i UDHEZUESIT Nr.001/2023

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Kërkesa 1

Kërkesa nga DT: Kërkohet që menaxheri i projektit të jetë i certifikuar me ISO 9001:2015 dhe Shëndeti e Siguria në Punë.

Arsyetim 1

Standardet ISO janë certifikime organizative që u përkasin kompanive dhe jo individëve. Kjo kërkesë krijon diskriminim ndaj operatorëve që posedojnë ISO si kompani, jo si individë.

Baza ligjore 1

Neni 59.2 i Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar me 05/L-092.

Neni 7 i Ligjit – parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.

Neni 33.3 i Rregullores Nr. 001/2021 të KRPP-së.

Kërkesa 2

Kërkesa nga DT: Kërkohet posedimi i standardit ISO 39001 për operatorin ekonomik.

Arsyetim 2

ISO 39001 aplikohet për kompani me kontrata të mëdha infrastrukturore. Për një projekt komunal me vlerë rreth 100,000 euro, kjo kërkesë është e pajustificueshme dhe joproporcionale.

Baza ligjore

Neni 59.2 i Ligjit.

Neni 27 i Ligjit.

Kërkesa 3

Kërkesa nga DT: Eskavator me peshë 7–8 ton.

Arsyetim 3

Kërkesa është diskriminuese. Eskavatorët 6.5 ose 9 ton kanë kapacitete pune të barabarta dhe përmbushin të njëjtat kërkesa teknike.

Baza ligjore

Neni 33.3 i Rregullores Nr. 001/2021.

Neni 59.2 i Ligjit.

Kërkesa 5

Kërkesa nga DT: Cilindër pesha min 7 ton - max 7.5 ton.

Arsyetim 5

Kërkesa është joproporcionale dhe diskriminuese. Cilindrat me peshë 6–10 ton kanë efikasitet të njëjtë në kompaktim.

Baza ligjore

Neni 59.2 i Ligjit.

Neni 33.3 i Rregullores Nr. 001/2021.

Kërkesa 6

Kërkesa nga DT: Makineri sheshuese dhe niveluese me libreze qarkullimi.

Arsyetimi 6

Kjo kërkesë është **teknikisht e pabazë dhe diskriminuese**, sepse këto makineri përdoren **vetëm brenda kantierit të punës**, nuk qarkullojnë në rrugë publike dhe zakonisht transportohen me rimorkio.

Ligjërisht, pajisjet e rënda të punishtes **nuk regjistrohen në trafik**, për sa kohë nuk përdoren për transport publik. Vendosja e kësaj kërkesë kufizon pjesëmarrjen e operatorëve.

Baza ligjore:

Neni **27** i Ligjit Nr. 04/L-042 – kërkon që specifikimet të lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës.

Neni **59.2** ndalon kërkesa që nuk kanë të bëjnë me natyrën e kontratës.

Neni **33.3** i Rregullores Nr. 001/2021 – ndalon kërkesa që nuk ndikojnë në cilësinë e punimeve dhe kufizojnë konkurrencën.

Kërkesa 7

Kërkesa nga DT: Dumper me peshë minimale 2.5 ton dhe maksimale 3 ton.

Arsyetim 7

Kërkesa për dumper me peshë të përcaktuar ngushtë (min. 2.5 ton, max. 3 ton) është **diskriminuese dhe joproporcionale**.

Në praktikë, kapaciteti i një dumperi nuk përcaktohet vetëm nga pesha por nga **volumi i transportit dhe fuqia e motorit**, prandaj çdo dumper nga 2 deri –5 ton kryen të njëjtën detyrë.

Një kufizim i tillë përjashton pajisje ekuivalente dhe favorizon operatorë që kanë modele

specifike, gjë që bie ndesh me parimet e konkurrencës së lirë.

Baza ligjore:

Neni 59.2 i Ligjit – kërkesat duhet të jenë të arsyeshme dhe proporcionale.

Neni 33.3 i Rregullores Nr. 001/2021 – ndalon përcaktime që përjashtojnë modele të tjera ekuivalente.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Nuk ka dëme në këtë fazë

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*